



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.128/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Adnan Konushevci dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Koalicionit PDK-AAK-NISMA, dega në Podujevë, për shkak të vendosjes së posterit mbi rrugë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 09.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, kështu që Koalicionit PDK-AAK-NISMA, dega në Podujevë i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 3.150.000 (*tremijë e njëqind e pesëdhjetë*) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Me datën 07.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje me të cilën pretendon se me datën 06.06.2017, aktivisti i tyre ka vërejtur se në rrugën “Zahir Pajaziti”, në Podujevë është vendosur një poster i koalicionit PDK-AAK-NISMA.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se nga ana e koalicionit PDK-AAK-NISMA, është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 4.1 pika b e Rregullës Zgjedhore të KQZ-së 11/2013, neni 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2014, sepse vendosja e materialit zgjedhor në apo mbi rrugë publike përbën veprim të ndaluar për subjektet politike, kandidatët dhe mbështetësit e tyre.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara nga vendi i ngjarjes në cilësi të provës materiale.

Në përgjigje në ankesë të datës 08.06.2017, koalicioni PDK-AAK-NISMA, konsideron se shkelja nuk është e qëllimshme, dhe se kjo është bërë nga aktivistë të painformuar mirë me rregullat zgjedhore, respektivisht me Rregullën Zgjedhore nr.11/2013, neni 4.1,(b), dhe se përkundër kësaj koalicioni me të pranuar ankesën kanë ndërmarr veprime për të përmisuar

shkeljen e pretenduar sipas Anr.128/2017. Si dëshmi ka bashkangjitur fotografi me të cilën dëshmohet largimi i posterit nga vendi ku kane qenë të vendosura ato.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli, nga fotografia e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, te cila gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimt, ka konstatuar se posterit i Koalicionit PDK-AAK-NISMA, është vendosur mbi rrugë publike, gjegjësisht në rrugën “Zahir Pajaziti”, e cila çështje nuk është mohuar as nga përgjigja në ankesë e Koalicionit PDK-AAK-NISMA.

Më këtë rast, PZAP-i, vlerëson se koalicioni i lartpërmendur ka bërë shkelje të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së, e cila dispozitë ligjore përcakton: *“Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në hapësira apo në rrugë publike”*

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjektet politike të koalicionit PDK-AAK-NISMA, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe se përkundër këtij fakti posterit i koalicionit është vendosur në hapësirë publike, gjegjësisht në rrugën “Zahir Pajaziti”, po ashtu e njëjta shkelje nga ky koalicion është përsëritur disa herë në këto zgjedhje.

Me rastin e vendosjes paneli mori parasysh edhe pretendimet e koalicionit të theksuar me lart, që theksohet se posterit në fjalë është vendosur nga aktivistë të painformuar mirë me rregullat zgjedhore dhe se shkelja e bërë nuk ka qenë e qëllimshme. Këto pretendime paneli i vlerëson si të paqëndrueshme dhe pa asnjë bazë ligjore sepse nenin 32 par.5 të LZP-së, përcakton se subjekti politik, mban përgjegjësi për shkeljen e kodit të mirësjelljes, të kryer nga anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e tyre.

Paneli poashtu vlerësoi me rastin e vendosjes, lidhur me gjobën e shqiptuar si në dispozitivë të këtij vendimi, përpjekjet e koalicionit PDK-AAK-NISMA, i cili ka ndërmarrë masa përmirësuese për evitimin e shkeljes së kodit të mirësjelljes, duke e larguar posterin nga

vendi që ishin të vendosur, me çka konstatohet nga fotografia e ofruar si provë që gjenden në shkresat e lëndës, të cilat masa përmirësuese kanë ndikuar në vendim-marrje, me rastin e shqiptimit të gjobës.

Lidhur me kërkesën e parashtruar nga subjektit politik LVV, e datës 09.06.2017, për tërheqjen e ankesës Anr.128/2017, të datës 07.06.2017, e parashtruar ndaj koalicionit PDK-AAK-NISMA, paneli vlerëson se vazhdimi i procedimit është në interesin e publikut dhe se në këtë rast tërheqja e njërës prej palëve të interesuara nuk sjell ndërprerjen e procedimit administrativ. Në neni 54 par.1 të Ligjit për Procedurën Administrative është parashikuar që *“Tërheqja e njërës prej palëve të interesuara nuk sjell ndërprerjen e procedimit administrativ në qoftë se organi kompetent i administratës publike gjykon se vazhdimi i procedimit është në interesin e publikut ose në interesin ligjor të palëve të tjera në procedim”*. Paneli nuk e bëri lejimin e tërheqjes së ankesës sepse ka vlerësuar se veprimi i koalicionit PDK-AAK-NISMA, ka cenuara interesin e publikut kjo aq më tepër kur kërkesës nuk iu ka shoqëruar asnjë provë në bazë të cilave do të dëshmohej se është bërë riparimi i shkeljes në teren, duke i tërhequr posterat nga vendi i palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, duke u nisur nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 32 par.2, nenit 118 par.1 dhe nenit 120 par.1 pika (c) të LZP-së, lidhur me nenin 51.4 të LPA-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.128/2017 më datën 09.06.2017.

**Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj**



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.